

## AUDITIMI I LARTË SHTETËROR - SHTETI QË LUFTON ANTISHTETIN

nga Albana GJINOPULLI<sup>1</sup> – Drejtore Drejtorie,  
botuar në gazetën “Telegraf”, më 06 maj 2015.

Përgjegjshmëria e përdorimit të fondeve publike është një gurë themeli për institucionet kombëtare që janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e shpenzimeve publike dhe ky këndvështrim e vendos Kontrollin e Lartë të Shtetit në krye të auditimit publik në vend. Me një profil të ri, KLSH sot luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin, analizën dhe së fundmi opinionin se kontrollet funksionojnë në mënyrë efektive, se ku janë identifikuar dobësitë, shkeljet dhe shpërdorime por mbi të gjitha në dhënien e sugjerimeve dhe rekomandimeve si institucionet publike të performojnë më mirë duke kontribuar në një masë të rëndësishme në mirëfunksionimin e qeverisjes së mirë në vend.



E gjendur në udhëkryq, rreth tre vite më parë ***KLSH bëri zgjedhjen që do t'i mundësonte ritjen, zhvillimin dhe do të mbështeste investimin afatgjatë*** për tu vendosur në pozicionin që i takon si element kyç në sistemin e menaxhimit financiar publik në Shqipëri, duke u aftësuar për dhënien e

sigurisë objektive dhe të pavarur tek parlamentarët, publiku dhe partnerët ndërkombëtarë se deri në ç'masë fondet publike janë menaxhuar me kujdes, janë përdorur për qëllimet e parashikuara, objektivat dhe rezultatet e pritshme janë arritur.

Standardet Ndërkombëtare, Kushtetuta dhe Ligji i japin KLSH, si auditim i lartë publik, funksionin e ruajtësit të përgjegjshmërisë publike, funksion ky që kërkon që audituesi të jetë i besueshëm dhe të rrisë kredibilitetin duke e realizuar auditimet në mënyrë parimore dhe etike. Adoptimi dhe zbatimi rigoroz i Kodit të Etikës për audituesit (ISSAI 30) i hapi rrugën promovimit dhe nxitjes së besimit dhe pritshmërive tek auditimi publik. Përpjekjet për të arritur Standarde më të larta të përgjegjshmërisë i japin KLSH autoritetin moral që të vlerësojë pritshmëritë në subjektet e audituara. Veprimtaria e KLSH gjatë vitit që lemë pas, jep indikacione të qarta se ky institucion punon fort për të kthyer përgjegjshmërinë në një nga tiparet e tij më të theksuar. Këto përpjekje e bëjnë ***KLSH si një hallkë kryesore në zinxhirin e përgjegjshmërisë publike***, jo vetëm në sensin e të ndihmuarit të të audituarve për të mbajtur ata të përgjegjshëm, por mbi të gjitha ta kryejë këtë funksion duke treguar përgjegjshmëri.

***KLSH kërkon të jetë i përgjegjshëm në konceptin më të gjerë për të gjithë komunitetin të cilit i shërben – taksapaguesve dhe publikut*** dhe jo vetëm organizmave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek auditimi sikurse është Parlamenti apo dhe ekzekutivi.

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) vepron si një organizatë ombrellë për komunitetin ndërkombëtar të auditimit. Ajo ofron një kuadër mbështetës për institucionet audituese për të nxitur zhvillimin dhe shkëmbimin e njohurive, përmirësimin e auditimit qeveritar në të gjithë botë dhe rritjen e kapaciteteve profesionale. KLSH prej vitesh ka qenë anëtar i kësaj organizate, por sot pozita dhe pjesëmarrja është rritur ndjeshëm duke kontribuar në komitete dhe grupe pune, si dhe në vënien në jetë të praktikave më të mira të vendeve anëtare.

***Iniciativa për zhvillim ka ardhur nga vetë KLSH*** dhe kjo në vetvete është një shfaqje e qartë e angazhimit të menaxhimit të lartë institucional të Kryetarit të KLSH. Nevoja për një udhëheqje të qartë dhe një strategji koherente është parakusht për çdo organizatë të suksesshme dhe si e tillë KLSH ka artikulluar gjithnjë e më shumë rolin e saj në terma të krijimit të vizionit dhe misionit, si dhe duke prioritarizuar objektivat më të rëndësishëm të saj të cilat janë mishëruar tashmë në Strategjinë e Zhvillimit që ka filluar të zbatohet prej vitit 2013 dhe shtrihet në vitet e ardhshëm deri në 2017. E hartuar me pjesëmarrjen e SIGMA/OECD Strategjia e Zhvillimit i shërben KLSH si një bazë e shkëlqyer për vendosjen e prioriteteve, alokimin e drejtë e të përshtatshëm të burimeve duke synuar gjithnjë arritjen e objektivave dhe menaxhimin e risqeve që sjellin sfidat e njohura e të panjohura të zhvillimit dhe progresit. Objektivat strategjikë të KLSH janë inkludim i objektivave të INTOSAI-t në zhvillimin e një institucioni të lartë të auditimit publik në ambientin shqiptar me fokus në të ardhmen.

Në rrugën e gjatë të zhvillimit që KLSH ka ndërmarrë e po ndjek, ndërtimi i kapaciteteve u shëndërrua në domosdoshmëri që ka mbështetur dhe mbështet progresin, që e ka ndihmuar dhe e ndihmon këtë institucion të shikojë përtej kufijve tradicional të inspektimeve financiare, duke menduar se si të shtojë vlerë jo vetëm brenda institucionit por dhe për njësitë e audituara.

***Njohuritë janë asetet më pak të prekshme, por mbeten faktor jetik për KLSH, jo vetëm në terma të efektivitetit por dhe të arritjes së sukseshme të objektivave strategjike.***

Kur KLSH përzgjedhi ndërtimin e kapaciteteve si një nga ndërmarrjet fillestare, ishte e ndërgjegjshme se investimet afatgjatë janë ato ç'ka nevojiten për të arritur zhvillim të qëndrueshëm të të gjitha aspekteve operacionale dhe menaxhuese të këtij institucioni. KLSH gjithashtu kuptoi se do ti duhej shumë kohë për të zhvilluar pozicionin e saj në sistemin e kontrollit parlamentar dhe për të bërë ndryshimin, duke ndikuar thellësisht në nxitjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në sektorin publik. Auditimi është një fushë mjaft komplekse teknikisht dhe si e tillë kërkon staf të trajnuar dhe të formuar profesionalisht në mënyrë që të sigurojë efektivitet.

Në vijim, të gjithë jeni dëshmitarë të ngjarjeve kur publiku kërkon të dijë rreth përgjegjshmërisë me të cilën zyrtarët publikë përdorin paratë e taksapaguesve dhe nëse audituesit zotërojnë aftësitë, profesionalizmin, ndershmërinë për të kryer punën dhe përmbushin misionin për të cilin janë caktuar.

Në përpjekje për të sjellë një imazh të ri të auditimit publik, një imazh që jo vetëm kërkohet nga standardet por që përputhet me pritshmëritë e publikut

për kontrollin e shtetit të tij, KLSH ka punuar intensivisht për tu prezantuar këtë fund viti me dimensione të reja.

Por asnjë iniciativë ndërtimi e zhvillimi nuk mund të jetë e suksesshme nëse nuk ekziston vullneti e dëshira e drejtimit për të ndryshuar. Po ashtu duhet dhe përfshirja dhe mbështetja e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, qofshin individë apo institucione e organizata.

Nga një “brainstorm” i situatës aktuale dhe të disa viteve më parë, çdo profesionist do të impresionohet nga shifrat dhe faktet që flasin për zhvillime përtej kufijve të parashikueshëm. Treguesit e performancës kanë ndryshuar përmbajtjen dhe domethënien e tyre, duke treguar se Auditimi i Lartë Shtetëror ka ndryshuar faqen dhe veprimtaria e KLSH ka filluar të lërë gjurmët e saj në krijimin e një profili me tiparet e një institucioni modern, që tregon performancë të lartë dhe thekson çdo ditë e më shumë përgjegjshmërinë ndaj Parlamentit dhe ndaj popullit të tij.

Mandati i auditimit është gjithëpërfshirës dhe Institucioni Suprem i Auditimit ka liri të plotë në ekzekutimin e përgjegjësive të veta. Këtu përfshihet e drejta për të bërë auditime të financave, të performancës dhe të respektimit të procedurave.

Sigurisht që KLSH nuk bën përjashtim nga përballja me vështirësitë dhe sfidat që sjell profesioni tepër delikat i auditimit. Nuk mungojnë rastet që audituesit ndjehen të kufizuar në mandatin e tyre, si në kryerjen e auditimeve ashtu dhe të raportimit mbi rezultatet në pajtueshmëri me standartet e pranuar ndërkombëtarisht. Ndonjëherë dhe proceset organizative dhe administrative

kufizohen dhe përballen me pengesa që ngadalësojnë zhvillimin dhe kufizojnë mandatin duke rezultuar më pas në vështirësi në arritjen e objektivave të auditimit.

Këto janë situata që vazhdimisht vlerësohen të jenë të lidhura me nivelin e pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit, që është dhe një parakusht për çdo progres për institucionet e larta audituese kudo në botë. Ligji i ri i Kontrollit të Lartë të Shtetit është një reflektim sa pozitiv aq dhe inovator i Standardeve Ndërkombëtare të fushës dhe i hap rrugë përkrahjes së rolit modern të auditimit, krijon mundësi të merren vendime të dobishme që i shërbejnë jo vetëm së tashmes, por e bëjnë KLSH të prezantohet me një tipar të ri si një institucion largpamës, që shikon qartë jo vetëm të sotmen por dhe në horizontet e së ardhmes.

Rruga e ndjekur vitet e fundit nga KLSH shkon përtej interesave të ngushta institucionale, duke u fokusuar në dobishmërinë e veprimeve në nivel të qeverisjes kombëtare.

Referuar tre vite më parë, Kryetari i porsazgjedhur, z. Bujar Leskaj paraqiste projekt idenë e tij, duke artikuluar qartë angazhimin që... “KLSH mund dhe duhet të pasqyrojë pesë parimet kryesore të një qeverisjeje të mirë: transparencën, përgjegjshmërinë, efikasitetin, pjesëmarrjen dhe koherencën në veprime. Për ta kryer këtë, KLSH mund dhe duhet të realizojë më fuqimisht standardet ndërkombëtare të kontrollit, si dhe Deklaratat më të fundit të miratuara nga INTOSAI ...KLSH do të shërbejë tërësisht si struktura numër një

dhe më e besueshme e informimit të Kuvendit për mirëadministrimin e pronës shtetërore, si për shumicën ashtu dhe për pakicën parlamentare ...”

Periudha e ardhshme pritet të jetë mjaft interesante. Nevoja e subjekteve publike për t'u audituar po bëhet gjithnjë e më e madhe, por shumë më tepër theksohet sfida për cilësi në auditim. Qasje të reja pritet të prezantohen ndërkohë që ambienti është gjithnjë e më i ndryshueshëm.

Pikëpyetje të reja vendosen para KLSH, si institucioni më i lartë auditues në vend, duke u kthyer në sfidë për institucionin i cili tashmë synon të zhvillojë më tej arritjet, të rrisë besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë.

Është e vështirë të parashikohet se çfarë do të sjellë viti 2015 për ne. Plot pyetje dhe shumë përgjigje të vështira, por e vetmja përgjigje e besueshme do të jetë ajo që e ardhmja do të tregojë, por me sigurinë se tashmë KLSH, ka hedhur themelet e forta të zhvillimit të mëtejshëm të tipareve të performancës, përgjegjshmërisë dhe largpamësisë si institucion auditues avangard.

---

<sup>1</sup> Shkrime të tjera të botuara nga Albana GJINOPULLI dhe Sali AGAJ për periudhën janar–qershor 2015:

- *KLSH dhe ndryshimi, sfida dhe arritje.*  
(Botuar në gazetën “Tirana Observer”, më 07 qershor 2015.)
- *Auditimi dhe sfida ndaj korrupsionit.*  
(Botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 12 qershor 2015.)